

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6991
E premte, 8 shtator 2023
Çmimi 0.40 €

Stoltenbergu pas takimit me Osmanin: Është thelbësore të shmangët përshkallëzimi i mëtejshëm



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

DËSHMITARI I 22-TË I ZYRËS SË PROKURORIT TË SPECIALIZUAR (ZPS) VAZHDON DËSHMINË NË HAGË NË PROCESIN GJYQËSOR NDAJ HASHIM THAÇIT, KADRI VESELIT, REXHEP SELIMIT DHE JAKUP KRASNIQIT

MBROJTJA E LIDERËVE TË UÇK-së: ABRAHAMSI KA PËRDORUR CITIMET E MEDIEVE SERBE



Mbrojtja e liderëve të UÇK-së edhe të enjten ka demoluar dëshmitarin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS), Federick Abrahams nga "Human Rights Watch (HRW)". Avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, para trupit gjykues ka thënë se Abrahamsi ka

përdorur citimet e medieve serbe në raportet e "HRW"-së për UÇK-në. "Ajo që keni bërë nuk është asgjë tjetër veç riciklim i raporteve dhe lajmeve serbe, më pas citoni veten tuaj", ka thënë Emmersoni. Ndërsa dëshmitari Abrahams është pyetur edhe për intervistat që kanë

realizuar gjatë kohës së luftës, por nuk ka qenë në gjendje të jepte shifra konkrete se sa të intervistuar asokohe nuk pranin të flisnin. Abrahamsi e ka pranuar se mund të ketë pasur raste edhe kur njerëzit janë sjellë si anëtarë të UÇK-së pa qenë në të vërtetë

AKTUALE




KUNDËROFENSIVA UKRAINASE PO PËRPARON

LAJÇAKU DHE BISLIMI BISEDONJË PËR TAKIMIN E NIVELIT TË LARTË TË JAVËS SË ARDHSHE

"ZËRI PERËNDIMOR I KOSOVËS", REZOLUTË NË PARLAMENTIN E ZVICRËS PËR GJYKATËN SPECIALE

EKONOMI



ÇFARË NDIKOI NË RËNIEN E PAPANËSISË E ÇFARË JO?

REAGIM I KMDLNJ-SË: LOJA PING-PONG ME TATIMIN NË PRONË, NË KURRIZ TË QYTETARËVE!

SPORT



ALITI DHE HADERGJONAJ: SHPRESOJMË QË TRI PIKËT TË MBESIN NË PRISHTINË

GAP-i: KRYETARËT E KOMUNAVE NUK I PËRMBUSHËN 636 PREMTIME



NËNSHKRUHET UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR TRAJTIM MJEKËSOR JASHTË INSTITUCIONEVE PUBLIKE



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kundërofensiva ukrainase po përparon

Kiev, 7 shtator - Forcat ukrainase kanë qenë në gjendje ta thyjnë mbrojtjen ruse dhe kanë bërë përparim në kundërofensivën e tyre ndaj trupave të Moskës, tha shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg. "Ukrainasit gradualisht po fitojnë terren dhe kjo dëshmon rëndësinë e mbështetjes sonë, por edhe të aftësisë dhe vullnetit tonë për ta vazhduar

mbështetjen", tha Stoltenberg para ligjvënësve të Bashkimit Evropian. "Këto janë luftime të ashpra, të vështira, por ata kanë qenë në gjendje ta thyjnë vijën e mbrojtjes së forcave ruse dhe po lëvizin përpara".

Në ditët e fundit Ukraina ka pretenduar se ka thyer vijat mbrojtëse të Rusisë gjatë kundërofensivës në jug të

shtetit.

Ukraina ka pranuar dërgesa me armë perëndimore nga shtetet e NATO-s, përfshirë tanke luftarake dhe makina të blinduara për ta ndihmuar atë në luftime. Por, Kievi e ka pranuar se kundërofensiva e nisur para tre muajsh ka qenë më e ngadalshme sesa ka shprehur fillimisht.



Stoltenbergu pas takimit me Osmanin: Është thelbësore të shmangët përshkallëzimi i mëtejshëm

"Epoka e re"

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë të enjten se për aleancën veri-atlantike është thelbësore të shmangët përshkallëzimi i mëtejshëm në veri të Kosovës. "U bëj thirrje të gjitha palëve t'i ikin retorikës nxitëse dhe të përmbahen në linjë me zotimet e tyre", ka thënë Stoltenberg. Ai i ka bërë këto deklarata në një konferencë për medie në Bruksel bashkë me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani.

Stoltenbergu ka thënë se dhuna ndaj pjesëtarëve të misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR në veri të Kosovës, më muaj më parë ka qenë e papranueshme. Sipas tij, stabiliteti i rajonit varet nga të gjitha palët. Ai e ka mirëpritur vendimin e autoriteteve të Kosovës për zvogëlim të pranisë policore në veri dhe planet për mbajtje të zgjedhjeve të reja në atë pjesë të vendit. "Në përputhje me përkushtimet e Prishtinës më 2013, çdo angazhim i forcave të sigurisë së Kosovës në veri kërkon negociimin me KFOR-in. Ne presim konsultime për secilin veprim të forcave policore të Kosovës që mund të ketë ndikim në siguri".

Ai e ka përmendur që pas trazirave



të fundit në veri, NATO-ja e ka rritur praninë në Kosovë. "KFOR-i vazhdon ta vëzhgojë situatën nga afër dhe jemi të gatshëm të veprojmë nëse kërkohet për ta përmbushur mandatin e Kombeve të Bashkuara, për të garantuar ambient të sigurt dhe liri të lëvizjes për të gjitha komunitetet në Kosovë".

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se Kosova dhe rajoni i Ballkanit po rrezikojnë të bëhen pika të trazirave për shkak të ndikimit malinj rus dhe

agjendave destabilizuese të saj. "Kosova po përjeton ndërhyrje të vazhdueshme prej jashtë dhe pengesë konstante të autoritetit të saj legjitim dhe sovranitetit në pjesën veriore të vendit tonë. Kjo në shumë raste ka përbërë agresion, siç përcaktohet në ligjin dhe praktikatat ndërkombëtare. Më lejoni të jem e qartë: pjesa veriore ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë pjesë integrale e Republikës së Kosovës", ka thënë Osmani.

Edhe Osmani e ka dënuar

dhunën ndaj zyrtarëve të KFOR-it në veri, duke thënë se nëse përgjegjësit e këtyre ngjarjeve nuk do të ndëshkohen, "ka rrezik që keqbërësit ta shohin këtë si dobësi tonë të përbashkët", duke shtuar se ata mund t'i përsërisin aktet e dhunës. Sipas saj, ngjarjet e 29 majit përbëjnë "sulm ndaj NATO-s", dhe ka thënë se Kosova ka gatishmëri të bashkëpunojë që keqbërësit të sillen para drejtësisë. Që kur u rritën tensionet në fund të majit në veri të Kosovës, NATO vazhdimisht u ka bërë thirrje të

gjithë faktorëve në rajon që të përmbahen nga veprimet që do të rrisnin edhe më shumë tensionet dhe të bëjnë hapa për qetësimin e situatës. Aleanca, po ashtu, ka përsëritur se mbetet e përkushtuar që përmes KFOR-it të sigurojë qetësi dhe siguri për të gjithë në Kosovë.

Kosova, ndërkaq, ka shprehur ambicet e saj për të ecur drejt integritimit në NATO, së pari përmes përfshirjes në Programin e Partneritetit për Paqe, më pas të bëhet anëtare e aleancës.

Por, në NATO kanë theksuar se për pranimin e anëtarëve të rinj duhet miratimi i të gjithëve në Aleancë. Në NATO katër nga 31 anëtarët nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, përkatësisht Spanja, Greqia, Rumania dhe Sllovakia.

Në një debat të enjten para Parlamentit Evropian, Stoltenbergu ka përmendur rëndësinë e bashkëpunimit mes NATO-s dhe Bashkimit Evropian në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor. "Ne jemi dy organizata të ndryshme, por ndajmë të njëjtat vlera. Mbi 600 milionë evropianë jetojnë në vendet anëtare të NATO-s. Kur Suedia të bëhet anëtare e aleancës, 96 për qind e qytetarëve të BE-së do të jenë në NATO", tha ai, duke nënvizuar rritjen e bashkëpunimit në mes të NATO-s dhe BE-së.

Ambasada ruse në Moldavi, lidhje të forta me spiunët

Kishinau, 7 shtator - Në muajin gusht Moldavia i ka përzënë 35 diplomatë rusë dhe anëtarë të Ambasadës, duke u thirrur mbi frikën se Moska po bën përpjekje për ta "destabilizuar" vendin, pasi hulumtimet e mediave gjetën një numër "të tepërt" të antenave në kulmin ndërtesës së ambasadës.

Por, diplomatët e lidhur me inteligjencën ruse janë në mesin e stafit të zvogëluar që ka mbetur në Ambasadën e Rusisë në Moldavi, pas

përjashtimeve masive, ka gjetur një hulumtim i ri i shërbimit moldavian të "Radios Evropa e Lirë".

Së paku dy nga këta diplomatë mbajnë lidhje me Shërbimin Federal të Sigurisë (FSB), agjencisë së fuqishme ruse të inteligjencës së brendshme, ndërsa dy të tjerë ndërlihdhen me adresat e drejtorisë së inteligjencës ushtarake të Rusisë në Moskë. E njohur si GRU, kjo organizatë është përfshirë në helmime dhe sabotime nëpër

Evropë, sipas të dhënave të regjistrave qeveritarë, të cilat i ka rishikuar REL-i.

Këto regjistra vijnë nga një varg bazash të të dhënave zyrtare të publikuara online falë tregut rus për publikimin e të dhënave, i cili ka ndihmuar në demaskimin e të dyshuarve në një sërë operacionesh të inteligjencës ruse në vitet e fundit. Ato përfshijnë automjete, punësime, pasaporta dhe kartela kreditore ruse që datojnë para një dekade.



PËRPARIMI I KRYETARËVE TË KOMUNAVE PËR PËRMBUSHJEN E PREMTIMEVE ZGJEDHORE GJATË MANDATIT 2021-2025

GAP-i: Kryetarët e komunave nuk i përmbushën 636 premtime



Instituti GAP ka publikuar shkallën e përmbushjes së premtimeve zgjedhore të dhëna nga kryetarët e komunave për mandatin 2021-2025. Prej 1 816 premtimeve të evidentuara në 27 komuna të ndryshme të Kosovës, 473 premtime (26 për qind) janë përmbushur, 285 premtime (16 për qind) gjysmë të përmbushura, 422 premtime apo (23 për qind) kanë filluar, dhe për 636 (35 për qind) premtime nuk është ndërmarë asnjë nismë për përmbushjen e tyre

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Në platformën elektronike "Letërnjoftimi i komunave", të enjten Instituti GAP ka publikuar shkallën e përmbushjes së premtimeve zgjedhore të dhëna nga kryetarët e komunave për

mandatin 2021-2025. Ky përditësim përfshin periudhën deri në fund të qershorit 2023. Prej 1 816 premtimeve të 27 kryetarëve të komunave, 473 premtime (26 për qind) janë përmbushur, 285 premtime (16 për qind) janë gjysmë të përmbushura, 422 premtime (23 për qind) janë të filluara, dhe 636 (35 për qind) e

premtimeve mbeten të pafilluara.

Numri më i madh i premtimeve të përmbushura janë nga fusha e arsimit, kulturës, ekonomisë dhe shërbimeve publike.

Te fusha e arsimit prin përmbushja e premtimeve në ofrimin e bursave, në krijimin e kabineteve dhe laboratorëve, në mirëmbajtjen e hapësirave shkollore, transparencës në përzgjedhjen e stafit, si dhe mbulimi i transportit për nxënësit.

Te fusha e ekonomisë disa nga premtimet e përmbushura ndërlidhen me mbështetjen e bizneseve të reja, krijimin e zyrave për biznes dhe mbështetjen e bizneseve në promovimin e produkteve të tyre. Kurse te fusha e shërbimeve publike, parkingjet

për automjete, shënjëzimi dhe sinjalizimi në komunikacion, ndriçimi publik, si dhe zgjerimi i hapësirave të gjelbra, janë ndër premtimet që janë përmbushur nga më shumë kryetarë të komunave.

Në fushën e kulturës janë përmbushur premtimet si organizimi i festivaleve dhe manifestimeve të ndryshme, ndarja e mjeteve buxhetore për mbështetjen e aktiviteteve teatrale, atyre të galerive dhe organizimeve të tjera kulturore. Ndërsa numri më i vogël i premtimeve të përmbushura janë nga fusha e urbanizimit, sportit dhe infrastrukturës. Në këtë të fundit, nga gjithsejtë 199 premtime të dhëna nga 27 kryetarë të komunave, deri më tani janë përmbushur vetëm 13 premtime (7 për qind).

Në periudhën e njëjtë të mandatit të kaluar kjo fushë printe me numrin e premtimeve të përmbushura. Ngecje vërehet edhe në fushën e urbanizimit sikurse në hartimin e planeve rregulluese, planeve zhvillimore, urbane dhe hartave zonale.

Instituti GAP bën monitorim periodik të realizimit të premtimeve në 27 nga 38 komuna të Kosovës, ngaqë disa nga kryetarët aktualë nuk kanë zhvilluar fushatë aktive zgjedhore.

Kryetarët e komunave sikurse Mamusha dhe të dhjetë komunave të banuara me popullatë me shumicë serbe nuk kanë shpallur ndonjë program zgjedhor dhe nuk kanë dhënë premtime konkrete.

Lajçaku dhe Bislmi bisedojnë për takimin e nivelit të lartë të javës së ardhshme

PRISHTINË, 7 SHTATOR - I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialog, Miroslav Lajçak, ka takuar të mërkurën vonë zëvendëskryeministrin e Kosovës, Besnik Bislmi, për të biseduar rreth përgatitjeve për një takim të nivelit të larg të dialogut në mes të Prishtinës dhe Beogradit javën e ardhshme. "Ne e patëm një diskutim të gjatë dhe përmbajtjesor për t'u përgatitur për takimin e dialogut të nivelit të lartë javën

e ardhshme", ka shkruar Lajçaku në "X".

Ai ka theksuar se përqendrimi i tyre kryesor në takimin e 6 shtatorit në Bruksel ishte "si të përparojmë në normalizimin e marrëdhënieve".

Më 31 gusht përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, ka njoftuar se takimi i radhës i kryeministrit të Kosovës, Albin Kurtit, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do të zhvillohet më 14 shtator.

Kurti dhe Vuçiqi janë takuar për herë të fundit më 2 maj, nëntë ditë pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme në veri të Kosovës, të cilat janë bojkotuar nga popullata lokale serbe. Që nga ajo kohë mes dy vendeve ka pasur një sërë tensionesh dhe krizash.

Më 30 gusht BE-ja përsëriti thirrjen për të dyja që të krijojnë një klimë për vazhdimin e dialogut.

Dy vendet, nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, janë në bisedime



për normalizimin e marrëdhënieve qysh në vitin 2011. Ndonëse kanë arritur dhjetëra marrëveshje në fusha të ndryshme, zbatimi i shumicës prej tyre ka ngecur.



DËSHMITARI I 22-TË I ZYRËS SË PROKURORIT TË SPECIALIZUAR (ZPS) VAZHDON DËSHMINË NË HAGË NË PROCESIN GJYQËSOR NDAJ HASHIM THAÇIT, KADRI VESELIT, REXHEP SELIMIT DHE JAKUP KRASNIQIT

Mbrojtja e liderëve të UÇK-së: Abrahamsi ka përdorur citimet e medieëve serbe

Mbrojtja e liderëve të UÇK-së edhe të enjten ka demoluar dëshmitarin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS), Federick Abrahams nga "Human Rights Watch (HRW)". Avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, para trupit gjykues ka thënë se Abrahamsi ka përdorur citimet e medieëve serbe në raportet e "HRW"-së për UÇK-në. "Ajo që keni bërë nuk është asgjë tjetër veç riciklim i raporteve dhe lajmeve serbe, më pas citoni veten tuaj", ka thënë Emmersoni. Ndërsa dëshmitari Abrahams është pyetur edhe për intervistat që kanë realizuar gjatë kohës së luftës, por nuk ka qenë në gjendje të jepte shifra konkrete se sa të intervistuar asokohe nuk pranonin të flisnin. Abrahamsi e ka pranuar se mund të ketë pasur raste edhe kur njerëzit janë sjellë si anëtarë të UÇK-së pa qenë në të vërtetë

EPOKA E RE

Lirim GECI

HAGË, 7 SHTATOR - Edhe të enjten ka vazhduar të merret në pyetje nga mbrojtja e liderëve të UÇK-së në Hagë, Federick Abrahams nga "Human Rights Watch (HRW)", i cili para Gjykatës Speciale është paraqitur si dëshmitar i Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS). Edhe në ditën e tretë të dëshmisë, Abrahams është përballur me shumë pyetje nga avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, por edhe avokatët e tjerë të krerëve të UÇK-së. Në raportet që Fred Abrahams i kishte hartuar ku fliste për krimet e

pretenduara të luftës nga pjesëtarë të UÇK-së, e kishte cituar Fondin për të Drejtën Humanitare. Por, avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka gjetur se fondi disa prej burimeve i kishte pasur nga mediet e Serbisë. Sikurse të mërkurën edhe të enjten avokati Emmersoni e ka "bombarduar" me pyetje dëshmitarin Abrahams. "Mjaftojnë këta shembuj për ta bërë këtë pyetje. Ku i keni marrë këta shembuj në raportet e mëpasshme, p.sh në tetor 1998? Ju keni botuar raport për ndalimet dhe abuzimet ku jepni informacionin e njëjtë. Keni bërë përsëritje. Ajo që duket se ka

ndodhur është se burimi ka qenë media serbe. Nga media serbe shkonte te Fondi për të Drejtën Humanitare, pastaj ju e merrnit si bazë atë që ka shkruar fondi. A e pranoni kronologjinë?", ka pyetur Emmersoni. "Me disa dallime", është përgjigjur dëshmitari Abrahams. Më pas dëshmitari ka kërkuar ta dinte për cilat medie bëhet fjalë. Në këtë raund pyetjesh disa herë ka ndërhyrë edhe ZPS-ja, duke kërkuar pyetje më konkrete nga avokati britanik i Veselit. "Së pari dua të di për cilën media bëhet fjalë, sepse në punën tonë kemi bërë dallim midis medieëve shtetërore. Bënim dallim mes

medieëve, sepse shteti kishte kontroll të fortë, dhe kishte organe të tjera mediale që ishin më të pavarura. Dua të di për cilën media?", ka deklaruar Abrahamsi, i cili ka pranuar këtë pyetje nga Emmersoni. "Ju nuk thoni në raportin tuaj që burimi është te një media e caktuar serbe. Ju thoni që ky është citimi juaj?", është deklaruar Emmersoni në formë të pyetjes. "Po. Ne kishim nivel të lartë besimi në Fondin për të Drejtën Humanitare. Unë nuk mbaj mend ndonjë bisedë që hulumtuesit apo autorët e tyre të kenë folur me ta për këto raste", është përgjigjur dëshmitari Abrahams.

Më tutje, avokati i Veselit, Ben Emmerson, ka insistuar sërish në marrjen e burimeve nga mediet në Beograd. "Deklarata e 20 prillit 2020. Aty thuhet se të gjitha hulumtimet e kryera nga Fondi Humanitar kishin një metodologji të përbashkët me atë tonën. Hulumtues të trajnuar me përvojë kanë intervistuar viktimat e dëshmitarë kokë më kokë. Kur ishte e mundur kemi marrë dëshmi nga kryesit e pretenduar. Kjo është deklarata për metodologjinë e raporteve tuaja. Ne sapo pamë këtë shembull ku ajo që keni bërë nuk është asgjë tjetër veç riciklim i raporteve dhe

lajmeve serbe, më pas citoni veten tuaj. Me fjalë të tjera, pasi kalon koha, ju nuk bëni as përfshirjen e medieëve as përfshirjen e Fondit, por thoni burimi jeni ne. Ju thoni që duhen disa burime, dhe thoni që janë bërë intervista të shumta me dëshmitarët por, nga ana tjetër, nuk e keni të përfshirë në raportet tuaja. Ju tregova që keni marrë burime nga mediet serbe", ka theksuar Emmersoni.

Po ashtu, Emmersoni e ka ballafaquar dëshmitarin me një deklaratë të tij të mëhershme ku kishte thënë se kanë mbledhur metodologji të ndryshme. "E kam përkrahur në mënyrë të vazhdueshme se si i jemi qasur kësaj pjese të raportit. Besoj se jepen 11 faqe metodologji. Kemi raportuar se sa e vështirë ishte të raportojmë për sjelljet e këqija të UÇK-së. Mandati ynë është përmbushur përmes mbledhjes të çështjeve dhe informacionit e burimeve të besueshme. Nuk është se kemi marrë burim vetëm qendrën, por edhe UNHCR apo gazetarë të tjerë. Kemi paraqitur burime të tjera në këtë pjesë. Ne besonim që kishte informacion të mjaftueshëm të këtyre burimeve për t'i mbështetur këto abuzime të pretenduara", ka thënë Abrahamsi. Avokati dhe dëshmitari janë përplasur pak edhe për referimin


“media serbe” apo “media nga Beogradi”. “Që të jemi të qartë e pranoj se ka media serbe të ndryshme. Ne këtu po flasim për mediet që keni përdorur, dhe burimi juaj ka qenë Fondi për të Drejtën Humanitare, dhe aty thuhet mediet nga Beogradi. Nëse vjen nga mediet e Beogradit te Fondi, është e rëndësishme të dihet gjatë vlerësimit të pretendimeve faktike, nëse është rezultat i metodologjisë që përshkruat ju, apo thjesht riciklim që vjen nga mediet e Beogradit?”, ka thënë Emmersoni, i cili ka marrë këtë përgjigje nga Abrahamsi: “Ky është vend geografik e jo përshkrim etnik”, ka thënë Abrahamsi.

Emmersoni e ka pyetur dëshmitarin se si e kishte kuptuar ai që shqiptarët ishin të frikësuar të flisnin për krimet e pretenduara të kryera nga pjesëtarë të UÇK-së. “Si ju ka thënë një dëshmitar që s’di gjë për një punë, sepse ju po flisni për një komunikim joverbal. Si e keni ditur që janë të frikësuar. Dua të më jepni një shembull si ka ndodhur?”, e ka pyetur Emmersoni. “Ka pasur mjedis që ka qenë i frikshëm duke pasur parasysh se lufta ka ndodhur. Ekzistonte frika. Dhe nga përvoja që kisha unë nga 1996 deri më 2001, është që hetimi i krimeve nga UÇK-ja ishte dukshëm më i vështirë”, është përgjigjur dëshmitari.

Megjithatë, dëshmitari nuk ka qenë në gjendje të jepte shifra konkrete se sa të intervistuar asokohe nuk pranoni të flisnin. Por, ai e ka pranuar se mund të ketë pasur raste kur njerëzit janë sjell si anëtarë të UÇK-së pa qenë në të vërtetë. “Besoj se thashë që mund të ketë pasur raste kur njerëzit janë sjellë si anëtarë të UÇK-së. Ka pasur individë që e ekzagjeruan rolin e tyre në luftime. Për ta bërë kështu në mënyrë të vazhdueshme do të ishte e rrezikshme, sepse ata individë që vërtet kishin sakrifikuar jetën e tyre nuk do të toleronin pretendime të pavërteta”, ka thënë dëshmitari.

Në vazhdim dëshmitari Abrahams është pyetur nga Emmersoni edhe për raportin e Dick Martyt. “Nuk jeni duke dhënë (dëshmi) para trupit gjykues si ekspert. Por, ju e dini që disa nga konstatimet në raportin e Dick Martyt, pas hetimeve pas shumë viteve, konstatimet e Martyt nuk kanë pasur prova, nuk ka asnjë pretendim në asnjë gjykatë për hetimin e trafikimit të organeve. Në atë kohë për ju ishte e qartë që kishte material të pamjaftueshëm për aktivitet të bashkërenduar?”, ka thënë Emmersoni.

Në përgjigjen e tij, Abrahamsi nuk është tërhequr nga disa deklarata të tij të mëparshme lidhur me raportin e Dick Martyt. “Do të doja pak pushim. Raporti i Dick Martyt nuk ishte fundi i historisë. Raporti dërgoi në krijimin e task-forcës speciale hetimore të BE-së që është drejtuar nga një diplomat ambasador i krimeve të luftës, Clint Williamson. Nëse shohim deklaratën përmblylëse të Williamsonit, thuhet shumë qartë se konstatimet e tyre, që gjetjet janë përgjithësisht në raport me



raportin e Dick Martyt. Janë intervistuar qindra njerëz nga task-forca. Atmosfera e frikësimit ka qenë e pranishme”, ka thënë Abrahamsi.

Pas kësaj përgjigje, Emmersoni ka thënë se dëshmitari Abrahams është duke përfshirë edhe institucione të tjera të cilat kanë qenë pararendëse të ZPS-së. “Ju po thoni që pretendimet për trafikim organesh nuk janë më të pranishme. Mendoj se task-forca nuk ka ndjekur këto pretendime, por ka 400 persona të zhdukur që nuk janë gjetur fare. Hulumtimet tona kanë marrë në tërësi këto dokumentacione”, ka thënë Emmersoni, duke thënë se dëshmitari nuk është në situatë të sugjerojë se krimet janë autorizuar kinse nga UÇK-ja. “Mbështetur në hulumtimet e akumuluar që janë botuar pas raportit të 1999-s, pasi i kam lexuar këto raporte, kam arritur në përfundimin që ka pasur nivel të lartë bashkërendimi”, ka thënë Abrahamsi, i cili e ka pranuar këtë pyetje nga Emmersoni. “Nuk të takon ty të vish në përfundime që kanë të bëjnë nëse kishte politikë qendrore. Pse e keni ndryshuar nga krime lufte, në abuzime pas luftës?”

Në këtë drejtim Abrahamsi ka thënë se konflikti i brendshëm i armatosur ka përfunduar më 12 qershor 1999. Dëshmitari Abrahams do ta vazhdojë dëshminë edhe të hënën, më 11 shtator.

Si arriti avokati britanik t'i 'rrëzojë' akuzat për 'abuzimet e UÇK-së' dhe çfarë thotë raporti i 'HRW'-së?

Avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka arritur pothuajse ta vë në dyshim komplet një raport të organizatës “Human

Rights Watch (HRW)” për “abuzimet e UÇK-së”, duke e bërë një përfaqësues të kësaj organizate, i cili është paraqitur si dëshmitar në Gjykatën Speciale në Hagë, që të pranojë se i kishin marrë për bazë pretendimet e palës serbe. “Dukej të ishte shkruar ndryshe”, ishin fjalët e shpeshta të dëshmitarit Frederick Abrahams, të cilat i ka përsëritur disa herë gjatë marrjes në pyetje nga avokati i Veselit. Raporti i “HRW”-së jep gjykimin se UÇK-ja kishte shkelur rregullat e luftës.

Frederick Abrahams, një përfaqësues i organizatës ndërkombëtare “Human Rights Watch”, është paraqitur si dëshmitar në gjykimin ndaj ish-udhëheqësve politikë dhe ushtarakë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Gjykatën Speciale në Hagë. Në cilësinë e dëshmitarit të 22-të në këtë rast gjyqësor, atij dje iu desh t’u përgjigjej pyetjeve të Ben Emmersonit, avokatit britanik të Kadri Veselit.

Emmersoni e ka bërë Abrahamsin të pranojë se së paku në një rast në të cilin “HRW”-ja e ka implikuar UÇK-në, pretendimet i kishin marrë nga pala serbe. Zyrtari i “HRW”-së ka thënë se do t’i përpilonte ndryshe fjalët në një raport ku akuzohej UÇK-ja për disa trupa të pajetë, të gjetur në Liqenin e Radoniqit në Gjakovë në shtator të vitit 1998.

Avokati Ben Emmerson ka nisur ta lexonte një pjesë të një raporti të “HRW”-së, ku ishte shkruar se si komandanti i rajonit të Dukagjinit duhet të kishte ditur, siç shkruhej në raport, “masakrën më të madhe që e ka kryer UÇK-ja më 1998”, ku sipas organizatës ishin vrarë 30-40 persona. Organizata këtu ka cenuar atë që ajo e dënon, ka theksuar Emmersoni, duke shtuar se “HRW”-ja e ka shpallur fajtorin pa hetime.

Avokati Emmerson ka lexuar edhe një paragraf ku thuhet se “komandantët e zonave kryenin krime, është e qartë si në vrasjen e shtatorit pranë Gllogjanit, komandantët e zonave duhet të kishin ditur, në mos të kishin urdhëruar drejtpërdrejt vrasjet”. Këtu Emmersoni ka thënë se 9 prej viktimave sa kishin qenë gjallë, ishin nën kujdesin e serbëve. “Duke ditur ato që dimë sot, këtë fjalë do ta përpiloja ndryshe”, ka thënë dëshmitari Abrahams.

Duke kujtuar se një gjykim për këtë rast kishte përfunduar dhe se i akuzuari ishte shpallur i pafajshëm, Emmersoni ka thënë se kjo vërtetonte se nuk kishte “organizatë të përbashkët kriminale” dhe se ai krim nuk kishte lidhje me asnjë prej komandantëve. “E pranoj gjithsesi se formulimi duhet të ishte bërë ndryshe”, ka thënë Abrahamsi, ndërsa avokati Emmersoni ka shpejtuar të theksonte se kjo çështje shkon përtej formulimit të fjalive, sepse vrasjet janë përshkruar si të kryera nga forcat e UÇK-së.

Dëshmitari sërish ka thënë se “duhej të ishte shkruar ndryshe”, fjalë të cilat i përsëriti disa herë, për të pohuar më pas se pretendimet i kishin marrë nga pala serbe.

Avokati i Veselit thoshte se viktimat kishin vdekur në vende e kohë të ndryshme dhe se trupat e tyre ishin hedhur në të njëjtin vend, ndërsa dëshmitari shqiptonte sërish fjalët e tij të shpeshta: “Dukej të ishte shkruar ndryshe”.

Organizata “HRW” nuk kishte bërë hetim të hollësishëm dhe nuk kishte shkruar ndonjëherë në vendin e krimit. Abrahamsi e ka pranuar këtë.

Më tutje, përfaqësuesi i “HRW”-së është ndalur te disa pjesë të tjera. Ai ka thënë se i qëndron prapa

deklaratës së tij se komandantët e zonave po të donin mund t’i kishin parandaluar veprimet kriminale.

Në anën tjetër, lidhur me rastin e “Kleçkës”, dëshmitari u pajtua se ekzistonte një fushatë nga serbët për t’i transportuar trupat nga Kosova në Serbi për t’u shfaqësuar duke fshirë gjurmët e krimeve. Por, ai ka thënë edhe se kishte dëgjuar se Serbia pretendonte se kishte zbuluar në një varr krime të kryera nga UÇK-ja dhe se ishin zbuluar trupa në Kleçkë.

Në një raport të titulluar “Shkeljet e së drejtës humanitare në Kosovë”, organizata ndërkombëtare e të drejtave të njeriut kishte shkruar për “shkeljet e rregullave të luftës” dhe “abuzimet nga UÇK-ja”. “Përkundër detyrimeve”, “HRW”-ja kishte konstatuar se “UÇK-ja ka kryer shkelje të së drejtës ndërkombëtare humanitare, duke përfshirë marrjen e pengjeve”.

Në disa raste në raport jepet gjykim për UÇK-në. Për shembull, për rastin e “Kleçkës”, “HRW”-ja kishte shkruar në raport se ishte “abuzimi më i rëndë i UÇK-së”. Pak më tutje, në të njëjtin paragraf, ishte theksuar gjithsesi rëndësia e një “hetimi të paanshëm”. “Human Rights Watch”, po në atë raport kishte thënë se “UÇK-ja gjithashtu ka bërë shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare, duke përfshirë marrjen e pengjeve dhe ekzekutimet pa gjyq”.

Procesi gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit ka nisur më 3 prill të këtij viti, ndërsa ata janë duke u mbajtur në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë deklaruar të pafajshëm për akuzat me të cilat është duke i ngarkuar Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë.

Çfarë ndikoi në rënien e papunësisë e çfarë jo?

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Papunësia në Kosovë brenda dhjetë vjetësh ka shënuar rënie mbi 17 për qind, tregojnë të dhënat e fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK). Nga 30 për qind sa ka qenë në vitin 2013, ka rënë në 12.6 për qind vitin e kaluar. Më saktësisht, sipas ASK-së, numri i të punësuarave në vitin 2013 ka qenë 338.365, ndërsa 403.813 më 2022.

Në dhjetë vjetët e fundit niveli i papunësisë në Kosovë ka shënuar rënie dhe ngritje. Rënia më e madhe ka ndodhur vitin e kaluar, në 12.6 për qind, ndërsa niveli më i lartë është regjistruar në vitin 2014 - mbi 35 për qind. Për profesorin e ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, Berim Ramosaj, rënia e papunësisë është reale, por nuk i atribuohet rritjes eventuale ekonomike. Sipas tij, faktor kyç që ka ndikuar në të është emigrimi i popullatës. "Ikja është e përqendruar te kontingjenti i punës, respektivisht te personat që janë në moshë pune dhe kanë vullnet që të hyjnë në tregun e punës", thotë Ramosaj për "Radion Evropa e Lirë".

ASK-ja nuk ka ende të dhëna për vitin 2022, por ato të vitit 2021 tregojnë se nga Kosova janë larguar mbi 42 mijë banorë për arsye të ndryshme.

Në vitin 2020 - kur ka shpërthyer pandemia e koronavirusit - kanë emigruar mbi 8 000 veta; më 2019 mbi 34 000 dhe më 2018 mbi 28.000.

Rritje e pamjaftueshme ekonomike

Ramosaj thotë se rritja ekonomike në Kosovë ka qenë e ulët për të gjeneruar mjaftueshëm vende të reja pune. Në dhjetë vjetët e fundit mesatarja nuk ka kaluar 4-5 për qind. "Rritja ekonomike njëshifrore nuk e adreson problemin e papunësisë", thotë ai.

Të dhënat e fundit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) parashikojnë që në vitin 2023 Kosova të ketë rritje ekonomike për 3.5 për qind, ndërsa në vitin 2024 për 4 për qind.

Përfaqësues të bizneseve thonë se as ata nuk kanë mundur të jenë kontribuues të mëdhenj në zbutjen e papunësisë. Sipas tyre, në dhjetë vjetët e fundit nuk ka



pasur lehtësira fiskale të cilat do t'i ndihmonin bizneset prodhuese të zhvilloheshin më shumë dhe, rrjedhimisht, të hapnin më shumë vende pune. "Në rast se investon në shtetet e rajonit, lirohesh nga një pjesë e madhe e tatimeve, si tatimi në fitim e të tjera, ndërkohë që në Kosovë nuk ka lehtësira të tilla", thotë për "Radion Evropa e Lirë" Skënder Krasniqi, drejtor i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Prishtinë. "Ne jemi vend importues i të gjitha produkteve dhe eksportojmë shumë pak. Tregtia hap më pak vende pune sesa do të mund të hapte sektori i zhvilluar i prodhimit", shton ai.

Të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës konfirmojnë, po ashtu, se investimet në sektorin e prodhimit janë më të vogla nëse krahasohen me sektorë të tjerë. Në katër muajt e parë të këtij viti numri më i madh i investimeve të huaja direkte në Kosovë është bërë në patundshmëri. Investuesit më të mëdhenj në këtë sektor janë qytetarët e Kosovës që jetojnë jashtë vendit.

Formalizmi i vendeve të punës

Profesori Ramosaj thotë se shifrat më të ulëta të papunësisë i ka ndikuar, deri

në njëfarë mase, edhe formalizimi i punësimit. "Së fundi është parë që bizneset, në përgjithësi, i deklarojnë punëtorët tek institucionet përkatëse, e që me vite i kanë mbajtur në të zezën", thotë ai. Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) vitin e kaluar ka nisur projektin e ashtuquajtur "Punësimi joformal", i cili ka për qëllim inspektimin e bizneseve, identifikimin e punëtorëve të paregjistruar dhe regjistrimin e tyre.

Ushtruesi i detyrës së drejtorit ekzekutiv të ATK-së, Ilir Murtezaj, ka thënë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" më 26 gusht se zbatimi i këtij projekti ka çuar, deri më tash, në identifikimin e mbi 7 000 punëtorëve të padeklaruar.

Krasniqi, nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë në Prishtinë, tërheq vërejtjen se jo të gjithë të papunët regjistrohen në Agjencinë e Punësimit dhe kjo, sipas tij, bën që shifrat e papunësisë të kenë trend të rënies. "Në vendet evropiane të papunët regjistrohen si të papunë, pasi përfitojnë mjete financiare nga shteti. Në Kosovë nuk përfiton asgjë dhe kjo është arsyeja që nuk lajmërohen si të papunë dhe papunësia del të jetë e vogël", thotë ai.

Të dhënat e Agjencisë së Punësimit të Kosovës flasin për rënie të numrit të punëkërkuarve.

Nga rreth 300 mijë punëkërkuar të regjistruar në vitin 2013, numri i tyre ka rënë në rreth 29 mijë në prill të këtij viti.

Papunësia bie, por punëtorë nuk ka

Edhe pse shifra e papunësisë mbetet mbi 12 për qind, bizneset në Kosovë, sidomos në dy vjetët e fundit, ankohen për mungesë punëtorësh. Disa, madje, kanë importuar fuqi punëtoresh nga jashtë.

Krasniqi thotë se kjo ndodh si pasojë e mungesës së harmonizimit midis arsimit dhe kërkesave të tregut të punës. "Ministria e Arsimit, për dhjetë vjet, i ka dhënë qytetarit shkollim që nuk i krijon vend pune. Ne arsimojmë të rinj [në ato fusha] që nuk u krijojnë të ardhme", thotë ai. Sipas Krasniqit, mungesë punëtorësh ka në sektorin e bujqësisë, të gastronomisë, të ndërtimtarisë dhe të tekstilit. Ndërtimtaria, njëherësh, thith edhe numrin më të madh të punëtorëve, ashtu si edhe tregtia e arsimit. Ministria e Arsimit, në anën tjetër, është në proces të zgjerimit të mësimin dual, që nënkupton aftësimin në një kompani të caktuar në kombinim me lëndët e një shkolle profesionale. Ky lloj mësimi ka filluar për herë të parë vitin e kaluar.

Ku janë mbi 750 mijë persona?

Sipas ekspertëve, një tjetër gjë që mbetet shqetësuese është shifra e personave ekonomikisht joaktivë - mbi 750 mijë, sipas të dhënave të ASK-së.

Me termin ekonomikisht joaktivë, ASK-ja përkrah personat që nuk janë as të punësuar, as të regjistruar si të papunë dhe as nuk kërkojnë punë.

Profesori Ramosaj ka një shpjegim: "Një pjesë [e personave ekonomikisht joaktivë] merret me veprimtari të pavarura që nuk janë të regjistruara si biznese, një pjesë ka të ardhura nga pasuria e paluajtshme dhe disa pranojnë remitenca dhe nuk punojnë". Me mbi 1.7 milion banorë, Kosova ka pagën më të ulët minimale në Evropë, që sillet nga 130 deri në 170 euro. Paga mesatare bruto në vend, për dhjetë vjet, është rritur për 138 euro. Nga 383 euro sa ka qenë në vitin 2012, ajo është bërë 521 euro në vitin 2022.

Ndryshe nga niveli i papunësisë në Kosovë, i cili ka shënuar rënie ndër vite, numri i personave ekonomikisht joaktivë ka shkuar kryesisht duke u rritur. Mbi 730 mijë apo 61.4 për qind e popullatës kanë qenë të tillë në vitin 2022.

SBASHK-u: Zëvendëskryeministër Bislimi, çfarë do t'i thuash Këshillit Ekonomik Social të Holandës?

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) përmes një reagimi ka theksuar se nga mediet ka kuptuar se zëvendëskryeministër Besnik Bislimi ka shkuar për vizitë në Holandë dhe se, përveç takimeve të tjera me deputetë dhe zyrtarë atje, do ta vizitojë edhe Këshillin Ekonomik Social të këtij shteti. "Urojmë që në këtë takim me anëtarët e këtij Këshilli do të merrni mësim se si zhvillohet dialogu social mes sindikatave dhe partnerëve të tjerë social dhe atë përvojë do ta sillni e do të vëni në jetë në Kosovë. Zëvendëskryeministër

Bislimi çka do t'i thuash Këshillit Ekonomik Social të Holandës? Tregoju të vërtetën se me fajin e Qeverisë sonë mungon dialogu i mirëfilltë social. Ju trego se nga marsi e këndej është dashur të shpallet konkurs për të aplikuar punëdhënësit, pra odat, dhe sindikatat për përbërjen e re të Këshillit Ekonomik Social, por kjo nuk ndodhi me fajin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ky Këshill nuk është funksional dhe nuk ka datë se kur do të bëhet një gjë e tillë", është thënë në reagimin e SBASHK-ut, duke iu drejtuar Bislimit se "a do t'ju tregoni se,



edhe përkundër të gjithë atyre angazhimeve të përfaqësuesve të sindikatave në këtë Këshill, tani e sa vite të punësuarit në sektorin privat e publik kanë

mbetur pa Marrëveshje të Përgjithshme Kolektive, e cila është bazë e realizimit e të drejtave të punëtorëve". SBASHK-u thekson se drafti i

kësaj marrëveshjeje është punuar qëmoti, por qeveria nuk kishte e nuk ka as sot e gjithë ditën gatishmëri për ta nënshkruar atë. "Zëvendëskryeministër Bislimi tregoju mikpritësve në Holandë se Qeveria e Kosovës ka qasje të gabuar ndaj dialogut social dhe ka pasur përpjekje edhe të përzihet në organizimin sindikal e madje edhe të shuaj zërin sindikal dhe se në vend të dialogut të sinqertë ka zgjedhur sulmet verbale dhe ironinë e talljet pa kripë ndaj udhëheqësve legjitim sindikalë", thuhet në reagimin e SBASHK-ut.

Nënshkruhet udhëzimi administrativ për trajtim mjekësor jashtë institucioneve publike

Përmes këtij udhëzimi gjithsecili qytetar i Kosovës gëzon të drejtën e mbështetjes financiare në vlerë deri në 30 000 euro brenda një viti për shërbimet që nuk ofrohen në institucionet publike shëndetësore në Kosovë. Ndërkaq personat me status të invalidit të luftës, anëtarët e ngushtë të familjes së dëshmorëve, viktimat civile të luftës do të kompensohen në shumën maksimale 100 për qind të vlerës së faturës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka nënshkruar udhëzimin administrativ për trajtimin mjekësor jashtë institucioneve publike. Në këtë udhëzim janë përditësuar dhe avancuar rregullat dhe procedurat nëpërmjet të cilave Qeveria e Republikës së Kosovës do t'i përkrahë financiarisht qytetarët për shërbime shëndetësore të cilat nuk ofrohen në institucionet publike shëndetësore. "Me UA nr: 03/2023, përveç që zgjerohet gama e shërbimeve për pacientët që kanë nevojë për trajtim jashtë vendit, evitohen zbrazëtitrat që pamundësojnë ofrimin e shërbimeve për qytetarët tanë dhe sigurojnë një proces të

rregullt dhe transparent. Gjithashtu, të gjithë qytetarëve rezidentë sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës u sigurohet e drejtë e qasjes së barabartë në kujdesin shëndetësor, respektivisht kur paraqiten kërkesa për trajtim mjekësor jashtë institucioneve publike. Me UA nr: 03/2023 parashihet për herë të parë Komisioni për përcaktimin e çmimeve referente që është kompetent ta propozojë përditësimin e shtojcës së çmimeve referente ku përfshihen sëmundjet, gjendja dhe procedurat për mbështetje nga programi për trajtim mjekësor jashtë institucioneve publike", ka njoftuar MSh-ja. Përmes këtij udhëzimi gjithsecili qytetar i Kosovës gëzon të drejtën e mbështetjes financiare në vlerë



deri në 30 000 euro brenda një viti për shërbimet që nuk ofrohen në institucionet publike shëndetësore në Kosovë. Ndërkaq personat me status të invalidit të luftës, anëtarët e ngushtë të familjes së dëshmorëve, viktimat civile të luftës do të kompensohen në shumën maksimale 100 për qind të vlerës së faturës. Gjithashtu,

njëjtë do të përfitojnë edhe personat deri në 18 vjeç, personat me aftësi të kufizuara dhe ata që janë përfitues të ndihmës sociale. Personat mbi moshën 18 vjeç kompensohen 70 për qind të vlerës së çmimit referent apo mesatares së çmimit të tri profaturave për trajtim mjekësor, ndërsa për personat e diagnostikuar me sëmundje

malinje mbi moshën 18-vjeçare është rritur vlera e kompensimit. "UA nr: 03/2023 ka thjeshtuar edhe procedurat e aplikimit për qytetarët, ndërsa referimi dhe përgjegjësia do të jetë te profesionistët shëndetësorë kompetentë të cilët rekomandojnë trajtimin jashtë vendit", ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë.

"Zëri Perëndimor i Kosovës", rezolutë në Parlamentin e Zvicrës për Gjykatën Speciale

PRISHTINË, 7 SHTATOR - "Zëri Perëndimor i Kosovës" do të përgatitë rezolutë në Parlamentin e Zvicrës për Gjykatën Speciale, ka bërë me dije drejtori i kësaj organizate, veprimtari Sali Bislimi. Ai ka bërë me dije se kjo rezolutë do të dorëzohet në sesionin parlamentar të Zvicrës që fillon javën e ardhshme. "Takim pune me nënkryetarin e Partisë së Qendrës, Die Mitte /Le Centre, senatori i Dhomës së Lartë Federative, koloneli i Ushtrisë, që mbështet

propozimin tim, miku im dhe i Kosovës, z. Charles Juillard! Presidenti Thaçi aktualisht është i paraburgosur në Hagë, në një nje të vërtetë gordiane, pasi në këtë fazë duket se ndikimet e jashtme politike kundër presidentit Thaçi ndërhyjnë në mbajtjen e një gjykimi të drejtë", ka shkruar Bislimi në "Facebook", i cili jeton dhe vepron në Zvicër. Ai ka shtuar se: "Në ankth për të respektuar rregullat themelore që kanë të bëjnë me një gjykim të paanshëm dhe të

drejtë që kam shqetësime në këtë gjykatë, prandaj 'Zëri Perëndimor i Kosovës' paraqet rezolutë në parlamentin Zviceran në sesionin parlamentar që fillon javën e ardhshme. Nënshkruarit e kësaj rezolute do kërkojnë nga Këshilli Federal që të sigurojë që zhvillimi i gjykimeve aktuale kundër ish-liderëve politikë të Kosovës të zhvillohet me drejtësi. Drejtësia krijon paqen, padrejtësitë ndaj shqiptareve kanë përfunduar!".



Aliu: Disa qese të plastikës ndalohen, disa bëhen me pagesë

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Qeset e plastikës janë bërë me pagesë e disa do të ndalohen krejtësisht falë finalizimit të Udhëzimit Administrativ, ka bërë me dije të enjten ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Liburn Aliu. Në një konferencë për medie mbajtur së bashku me shefin për bashkëpunim në Zyrën e BE-së në Kosovë, Alessandro Bianciardi, Aliu tha se ndalimi i qeseve të plastikës nga 0 deri 25

micron do të jetë i menjëhershëm, ndërsa do të lejohen vetëm qeset për fruta. Ministri Aliu tha se do të lejohet përdorimi i qeseve nga 25 deri në 50 micron të cilat do të kushtojnë 0.05 euro, pa logo të prodhuesve. “Me udhëzimin administrativ që ka të bëjë me qeset e plastikës do t’ju informoj se do të kemi ndalim të qeseve të plastikës, mbajtëse nga 0 deri 25 micron. Pra, qeset e holla të plastikës të cilat përdoren sot


dhe mund të merren në markete falas do të ndalohen plotësisht. Nga 0 deri 25 micron do të lejohen vetëm qeset të cilat përdoren për fruta e nuk do të kenë ato mbajtëset. Ndërsa qeset nga 25 deri në 50 micron do të lejohen dhe do të kushtojnë 0.05 euro, por nuk do të lejohet të kenë logo të prodhuesve”, ka thënë Aliu. Po ashtu, ai ka thënë se do ta ndalojnë prodhimin e importeve dhe të shitjes në treg të qeseve plastike mbajtëse ose degraduese.



REAGIM I KËSHILLIT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE TË LIRIVE TË NJERIUT (KMDLNJ)

Loja ping-pong me tatimin në pronë, në kurriz të qytetarëve!

Në fillim të vitit 2023 qytetarët e Kosovës u shokuan me vlerësimin e pronave të tyre që tatimohen për faktin se, për dallim nga viti paraprak, shuma e tatimit ishte 100 e më shumë për qind më e lartë. Shpërthyen reagimet e shumta që kundërshtuan këtë rritje jonormale aq më parë që ishte një përqendrim i gjendjes materiale për shumicën e qytetarëve, për shkaqe objektive dhe subjektive. Adresa e parë e identifikimit të përgjegjësishë ishin komunat shkak se ato edhe i merrnin paratë nga tatimi në pronë. Ministria për Financa fillimisht nuk u deklarua deri atëherë kur komunat e ngarkonin me përgjegjësi, si për rritje jonormale të tatimit në pronë sikur edhe për faktin se komunat nuk qenkan konsultuar fare për këtë rritje dhe se Ministria e ka bërë këtë veprim në mënyrë arbitrare. Madje, komunat, në emër të solidarizimit me qytetarë kërkonin që shuma e tatimuar të jetë e njëjtë me vitin paraprak, sikur që kishte propozime që për shkak të gjendjes së rënduar ekonomike kjo shumë të ulet apo edhe të falen nga kjo barrë. Ministria, si autoritet



arbitrar as që mori për bazë kërkesat e komunave të cilat, pas një kohe del të jenë të pasinqerta dhe mashtruese. Ministria e Financave, pa asnjë bazë ligjore propozoi që qytetarëve t’u falen nga 100 euro duke e shndërruar në mundësi për përfitime politike gjë që e realizoi përmes ndryshimit të ligjit i cili edhe u votua në Kuvendin e Kosovës. Në ndërkohë njohësit e çështjeve kushtetuese deklaruan se ky ligj shkelë të drejtat e komunave dhe si i tillë është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës të cilën e shfrytëzuan kryetarë të komunave për ta dërguar lëndën në Gjykatën Kushtetuese e që së voni e bëri

edhe Asociacioni i Komunave të Kosovës i cili derdhte lotë krokodili për rritje të tatimit në pronë dhe vajtonte fatin e qytetarëve të Kosovës që po keqtrajtohen financiarisht nga Ministria e Financave. Doli që të dy adresat konfrontuese, Ministria e Financave dhe AAK-së janë mashtrues që e sulmojnë njëra - tjetrën vetëm për ta mbuluar mashtrimin që e bëjnë. Ministria e Financave caktoi datën 15 shtator 2023 kur komunat duhet ta zbatojnë këtë vendim, në njërin anë kurse, në anën tjetër zbatimin e ligjit e shndërruan në vullnet fakultativ (joobligues) të komunave në kohën kur asnjë ligj nuk mund të zbatohet në

mënyrë selektive por se duhet të jetë i zbatueshëm për të gjithë, pa asnjë dallim. Katër - pesë komuna morën vendim për zbatimin e Ligjit në ndërkohë Gjykata Kushtetuese e Kosovës mori vendim procedural për pezullim të nenit 5 të Ligjit duke e bërë të pamundur faljen e 100 eurove. Nga momenti kur ekspertë të çështjeve kushtetuese e kundërshtuan propozimin e Ministrisë së Financave për falje të 100 eurove, Asociacioni i Komunave në përgjithësi dhe komunat në veçanti filluan të llogarisin humbjet që do ta kishin komunat me këtë falje duke injoruar pandershmërisht interesat e qytetarëve (votuesve) që u dëmtuan shumë me këtë rritje. KMDLNj-ë e ngre një pyetje shumë të thjeshtë; “Çka do të bënin komunat nëse shuma e tatimit në pronë edhe në këtë vit do të ishin të njëjta me vitin e kaluar, pa shumën enorme që i shtohet në tatim të vitit 2023”? Komunat kanë bërë llogari vetëm për interesat e ngushta duke mashtruar dhe dëmtuar shumë qytetarë. Po krijohen kushtet, me mjetet e plaçkitura përmes tatimit në pronë që edhe komunat tjera

të blejnë biçikleta prej 3000 eurove siç bëri komuna e Prishtinës, veprim krejtësisht i pamoralshëm aq më parë që shumë probleme komunale janë të pazgjidhura e që paraqesin prioritet për qytetarët. KMDLNj e kundërshton këtë veprim të pamoralshëm dhe mashtrues të Ministrisë së Financave dhe Asociacionit të Komunave që për pasojë do të penalizojë qytetarët e Kosovës trefishë; përmes rritjes jonormale të tatimit në pronë që duhat ta paguajnë, pamundësinë e faljes së 100 eurove dhe kamatave të larta për mospagim të tatimit në pronë në kohën kur kishte paqartësi se si do të përfundojë mashtrimi ordiner i këtyre dy përgjegjësve për plaçkitje të paskrupullit të qytetarëve. KMDLNj thërret qytetarët e Kosovës ta kundërshtojnë shtrenjtimin jonormal të tatimit në pronë përmes kundërshtimit ligjor kurse, sa i përket ndëshkimit për pandershmërinë, qytetarët - votues duhet të jenë shumë të kujdesshëm për kënd do të votojnë në zgjedhjet e ardhshme parlamentare dhe lokale, kurdo që ato do të mbahen.

Shpërndahen 380 pajisje bujqësore për fermerët lipjanas


LIPJAN, 7 SHTATOR - Komuna e Lipjanit ka pajisur me makineri bujqësore 380 fermerë nga subvencionet e ndara nga buxheti i komunës. Kjo përkrahje e fermerëve është bërë përmes shpërndarjes së frezave, spërkatësve dhe shpërndarësve të plehut. Kryetari i komunës, Imri Ahmeti, gjatë procesit të shpërndarjes së këtyre pajisjeve bujqësore, ka thënë se ky lloj subvencionimi ka për qëllim zhvillimin dhe avancimin e bujqësisë në Lipjan. “Me këtë

përkrahje ndaj fermerëve do të avancojmë dhe ta zhvillojmë bujqësinë edhe më tutje. Edhe në vitet e ardhshme do t’i mbështesim fermerët tanë me qëllim të lehtësimit në punën e tyre, por edhe në rritjen e sasisë dhe cilësisë së produkteve bujqësore”, ka thënë Ahmeti, duke shtuar se kjo pasuri le të shërbejë që të punohet çdo pëllëmbë tokë. Ndërsa drejtori i Bujqësisë dhe Pyltarisë, Rexhep Rexhepi, ka pohuar se kjo ndihmë është e mirëseardhur për fermerët lip-

janas, të cilët do ta kenë më të lehtë punën në bujqësi. “Është investuar mjaft shumë në infrastrukturë si: shkolla, çerdhe të reja, ura e shumë projekte të tjera, por kjo është një ndihmë tjetër e cila do t’i ndihmojë bujqut dhe do të ndikojë në zhvillimin e komunës”, ka thënë drejtori Rexhepi. Të lumtur me këtë mbështetje u shprehën edhe fermerët përfitues, të cilët falënderuan komunën, konkretisht kryetarin Imri Ahmeti, i cili për çdo vit po gjen mundësi për t’i përkrahur.



Albert Einsteini për shkencën, fenë, luftën, paqen dhe njerëzimin...



Për shkencën

“Imagjinata është më e rëndësishme sesa dija.”

“Nëse e ne do e dinim se çfarë po bënim, nuk do të quhej kërkim, apo jo?”

“E vetmja arsye për ekzistencën e kohës, është që çdo gjë të mos ndodhë menjëherë.”

“Çdo gjë duhet të jetë aq e thjeshtë sa të jetë e mundur, por jo më e thjeshtë se aq.”

“Shkenca është një gjë e mrekullueshme nëse nuk të duhet të nxjerrësh jetesën me të.”

“Çdo budalla inteligjent mund t'i bëjë gjërat më të mëdha dhe më komplekse ... Duhet një prekje gjenialiteti dhe shumë guxim për të lëvizur në drejtimin e kundërt.”

“Për çdo miliard grimca të antimateries, ka pasur një miliard e një grimcë materie. Dhe kur përfundoi asgjësimi i ndërsjellë, mbeti një e një miliardta – dhe ky është universi ynë.”

“Sa kohë që ligjet e matematikës i referohen realitetit, ato nuk janë të sigurta dhe, për kohë sa janë të sigurta, nuk i referohen realitetit.”

“Gjëja më e pakuptueshme për botën është se ajo është e kuptueshme.”

“Unë pohoj se ndjenja fetare kozmike është motivi më i fortë dhe më fisnik për kërkimin shkencor.”

Për fenë

“Perëndia nuk luan bixhoz me universin.”

“Shkenca pa fe është e çalë, feja pa shkencë është e verbër.”

“Qeniet njerëzore, perimet, ose pluhuri kozmik, ne të gjithë kërcëjmë sipas një ritmi misterioz, i vendosur në distancë nga një lojtar i padukshëm.”

“Unë dua të di mendimet e Perëndisë ... pjesa tjetër janë detaje.”

“Është e çuditshme situata jonë këtu në këtë tokë. Secili prej nesh vjen për një vizitë të shkurtër, duke mos ditur përsenë, e prapëseprapë, ndonjëherë duket sikur ka një qëllim hyjnor.”

“A besoj në pavdekshmërinë? Jo, dhe një jetë është e mjaftueshme për mua.”

“Shkencëtarët u quajtën heretikë

të mëdhenj nga kisha, por ata ishin në të vërtetë njerëz më se fetarë, për shkak të besimit të tyre në rendin e universit.”

“Kur zgjidhja është e thjeshtë, Perëndia është duke u përgjigjur.”

jo për shkak të atyre që bëjnë keq, por për shkak të atyre që rrijnë e shohin pa bërë asgjë.”

“Paqja nuk mund të arrihet përmes dhunës, por mund të arrihet vetëm nëpërmjet mirëkuptimit.”

gjenialitetit është se gjenialiteti ka kufijtë e vet.”

“Është bërë frikshëm e qartë, se teknologjia jonë ka tejkaluar humanizmin tonë.”

“Vetëm një jetë e jetuar për të tjerët është jetë e vlefshme.”

Për arsimin

“Arsimi është ajo që mbetet pasi ke harruar gjithçka që ke mësuar në shkollë.”

“Mësimdhënia duhet të jetë e tillë që, ajo që ofrohet të perceptohet si një dhuratë e çmuar dhe jo si një detyrë e vështirë.”

“Shembulli nuk është thjesht një tjetër mënyrë për të mësuar, është mënyra e vetme për të mësuar.”

“Mençuria nuk është produkt i shkollimit, por i përpjekjes gjithëpërfshirëse për ta fituar atë.”

“Leximi, pas një moshe të caktuar, largon mendjen nga shumë qëllime të veta krijuese. Çdo njeri që lexon shumë dhe përdor shumë pak trurin, bie në zakone të këqija të të menduarit.”

Përgatiti: Bota.al



Për luftën dhe paqen

“Nuk e di se me çfarë armësh do të luftohet Lufta e Tretë Botërore, por Lufta e Katërt Botërore do të luftohet me shkopinj dhe gurë.”



“Bota është një vend i rrezikshëm,

Për njerëzimin

“Vetëm dy gjëra janë të pafundme, gjithësia dhe marrëzia njerëzore, dhe unë nuk jam i sigurt për të parën.”

“Dallimi midis marrëzisë dhe





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Aliti dhe Hadërgjonaj: Shpresojmë që tri pikët të mbesin në Prishtinë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Futbollistët e Përfaqësueses së Kosovës i kanë vazhduar përgatitjet për ndeshjen ndaj Zvicrës edhe të enjten në Kampin Nacional në Hajvali. Ndeshja në mes të Kosovës dhe Zvicrës zhvillohet të shtunën në mbrëmje në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, ndërsa është e vlefshme për kualifikimet për "Euro 2024". Atmosfera në kampion e "dardanëve" është jashtëzakonisht e mirë. Përzgjedhësi Primozh Gliha ka punuar në aspektin taktik, në vendosjen sa më të mirë të ekipit në fushë, por edhe në skema të ndryshme gjatë lojës.

Pas stërvitjes kanë folur dy mbrojtësit, Fidan Aliti dhe Florent Hadërgjonaj. Mbrojtësi qendror Fidan Aliti ka thënë se ndeshja është e rëndësishme dhe emocionuese. Ai beson se me përkrahjen e tifozëve tri pikët do të mbesin në Prishtinë. "E dimë rëndësinë e ndeshjes dhe besoj se do të jemi të gatshëm. Është emocionuese sepse kam lindur në Zvicër, familja jeton atje. Zvicra është një shtet dhe një kombëtare, ku me punë dhe disiplinë ka arritur në këtë nivel. E dimë se do të jetë një ndeshje e vështirë, por me tifozët tanë dhe mbështetjen e tyre shpresojmë që tri pikët të mbesin këtu. Do të jetë emocion i madh të hyjmë në stadium, i cili do të jetë i mbushur përplot me tifozë dhe mbështetja e tyre na bën më të fortë. Do të jetë e vështirë të fitohet ndeshja pa mbështetjen e tifozëve 'Dardanët'", ka thënë Aliti.

Optimizëm për ndeshjen ndaj



zvicranëve ka shprehur edhe mbrojtësi anësor Florent Hadërgjonaj. Ky ka shprehur bindjen se është koha që Kosova t'u kthehet rezultateve pozitive. "Kemi ushtruar shumë fort dhe synimi është t'i kthejmë rezultatet pozitive për ta kthyer përkrahjen edhe më të madhe të tyre. Kohët e fundit ka qenë një kohë e vështirë, na kanë munguar rezultatet, por tash e kemi rastin kundër një kundërshtari të fortë në shtëpi ta kthejmë pozitivitetin", ka thënë Hadërgjonaj. "Duhet të jemi të bashkuar, pasi e dimë se do të jetë një ndeshje e vështirë. Besoj se ekipi do të jetë gati për këtë përballje. Zvicra ka mungesë të pikëve dhe vjen për tri pikë dhe jo për të luajtur ndeshje vëllazërore. Na duhet mbështetja e madhe për të na motivuar, pasi luajmë këtu në 'Fadil Vokrri', por mbështetja do të kishim edhe po të luanim në Zvicër. Ndeshja këtu do të jetë diçka më speciale. Edhe për

zvicranët do të jetë e veçantë ashtu si edhe për ne. Kur luajmë në shtëpi e japim maksimumin. Tifozët mbrapa na japin zemër dhe besoj se edhe në fushë duhet të luajmë me zemër në mënyrë që edhe tifozëve t'u japim energji për të na përkrahur më shumë", ka theksuar Hadërgjonaj. Në Grupin I Kosova është në vendin e pestë me vetëm tri pikë, kurse Zvicra renditet në vendin e parë me 10 pikë.

Fillon shitja e biletave për ndeshjen Rumani - Kosovë

Federata e Futbollit të Kosovës ka njoftuar se ka filluar shitja e biletave për sektorin e tifozëve të Kosovës për ndeshjen Rumani - Kosovë. Kjo ndeshje është paraparë të zhvillohet më 12 shtator në orën 20:45 në "National Arena" në Bukuresht të Rumanisë. Biletat mund t'i blini përmes platformës online.

SHKURT

Rama: Formula 1 e garave botërore të ujit, sezonin e ardhshëm në Pogradec

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, solli të enjten në vëmendje aktivitetin e garave botërore të ujit që pritet të zhvillohet vitin e ardhshëm në Pogradec. Përmes një postimi në rrjete sociale, Rama bëri me dije se 43 skuadra nga e gjitha bota do të jenë për shtatë ditë në Pogradec. "Formula 1 e garave botërore të ujit vjen në Pogradec më korrik 2024, si pararendëse e Formula 1 në garat me makina, që do të vijë në Elbasan pas pak vitesh, kur ta kemi përfunduar cirkuitin e kaluar të të gjitha testet e kërkuara. 43 skuadra nga e gjithë bota do ta kthejnë Pogradecin në kryeqendrën botërore të sporteve ujore për 7 ditë, sepse Shqipëria turistike tanimë është ngjitur në një nivel të ri", ka shkruar Rama.

KB Prishtina transferon amerikanin Steven Davis

KB Prishtina ka njoftuar se e ka transferuar basketbollistin Steven Davis. Amerikani 29-vjeçar vjen në kryeqytet pas një përvoje të pasur e me shifra të mrekullueshme në liga të ndryshme evropiane si në: Hungari, Sllovaki, Suedi, Gjermani dhe Itali. Ai luan në pozitën e alo-qendrës dhe së fundmi ka qenë pjesë e skuadrës së famshme italiane Fortitudo Bologna dhe skuadrës tjetër Trapani.

Mirela e pandalshme, 13 gola në elitën e Norvegjisë

Mirela Gjokokaj po kalon superformë në Norvegji. Lojtarja jonë të mërkurën ishte më meritorja për fitoren e Follos ndaj Tertnesit. Në kuadër të xhiros së dytë të elitës norvegjeze, Follo fitoi me rezultat 30:23. Mirela i shënoi plot 13 gola, me efikasitet shumë të lartë. I kishte vetëm 14 tentime. I kishte edhe dy asistime e, po ashtu, dha kontribut në mbrojtje. Forma e saj është trimëruese në prag të ndeshjeve të ardhshme të Kosovës.

Skuadra e Qunit barazon me kampionin zvicran

Luigj Quni ka shënuar tri gola nga tri tentime për skuadrën Amicitia Zuerich, që luajti ndeshjen e parë në kampionatin e ri. Skuadra nga Zuerichu nisi mbarë duke barazuar 26:26 me Kadetten Schaffhausen. Schaffhauseni ishte nikoqir. Kjo skuadër është kampione në Zvicër. Kreuzlingeni humbi 25:22 nga Wacker Thuni. Kreuzlingeni ishte vendas. Drenit Tahirukaj i shënoi 7 gola. Valon Dedaj dy gola, kurse kontribut në mbrojtje dha Bujar Ramosaj. Haris Berisha kishte paraqitje të mirë duke u shpallur më i miri te Kreuzlingeni.

Peja nis mbrojtjen e titullit ndaj Vëllaznimit, Superliga e Femrave nis me derbi

PRISHTINË, 7 JANAR (ER) - Në zyrat e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) është hedhur shorti për edicionin e ri në Prince Caffè Superligë dhe Superligën e Femrave. Në xhiron e parë, kampioni i Kosovës te meshkujt, KB Peja, do të përballlet me Vëllaznimit, kurse nënkampionia, Trepça, me Istogun, i cili siguroi garat në elitë. Ndërkohë, Sigal Prishtina do të ndeshet me

Proton Cable Prizrenin, kurse ndeshja tjetër është Golden Eagle Ylli - Bashkimi. Edicioni i ri në Prince Caffè Superligën e Kosovës në basketboll do të fillojë më 22 shtator. Në anën tjetër, Superliga e Femrave pritet të jetë shumë interesante në këtë edicion, kurse do të fillojë më 6 tetor. Në xhiron e parë Peja 03 e shumëpërforcuar do të përballlet me Prishtinën, që

shihet derbi i kësaj jave. Ndërkohë, Bashkimi, që është kampion aktual, do të sfidohet nga Trepça. Takimi tjetër i xhiros së parë është në mes të United Basketball dhe Penzës. Meshkujt: Golden Eagle Ylli-Bashkimi, Istogu-Trepça, Sigal Prishtina-Proton Cable Prizreni, Peja-Vëllaznimi. Fermat: Bashkimi-Trepça, United Basketball-Penza, Peja 03-Prishtina.



Ramos: Para pensionimit e dua një trofe me ekipin tim të zezës

Paris, 7 shtator - Pas përfundimit të kontratës me gjigantët francezë të Paris Saint-Germain, të shumta ishin aludimet se ku do ta vazhdonte karrierën e tij dhe pas shumë negociatash me

klube të ndryshme, vendosi të rikthehej tek "andaluzianët" e Sevillas. Sergio Ramos ka folur për herë të parë pas rikthimit në La Liga, teksa duket i uritur në maksimum për të fituar të

paktën një trofe me "andaluzianët" para tërheqjes përfundimtare nga futbollit. "Kur vjen koha për ta menduar rikthimin, është një çështje shumë emocionale. Për t'u kthyer në shtëpi dhe

për ta pasur mundësinë për të mbyllur një cikël me klubin ku kam lindur. Para se të vdes do të doja të fitoja diçka me ekipin tim të zezës. Shpresoj që të mund të kontribuoj sa më shumë", ka thënë Ramosi.



Tare: Pioli dhe Inzaghi janë empatikë, por të ndryshëm taktikisht

TIRANË, 7 SHTATOR - Igli Tare, pas largimit nga skuadra e Lazios si drejtor sportiv, ka gjetur kohën për ta dhënë opinionin për situatën. Në një intervistë për prestigjiozen italiane "La Gazzetta dello Sport", Tare ka folur për kampionatin italian në tërësi dhe më pas është ndalur te dy ekipet, që duket të jenë pretendentet kryesorë për fitimin e titullit këtë vit, Inter e Milan, ku ka

folur në veçanti për trajnerët e këtyre dy skuadrave. Në komentin e tij për teknikun "zikaltër" Simone Inzaghi dhe atë të "kuqezinjve", Stefano Pioli, ish-"bomberi" i kombëtares shqiptare u shpreh se trajnerët arrijnë ta kuptojnë një-tjetrin mjaft mirë, por janë të ndryshëm në taktikë. "Pioli dhe Inzaghi: empatikë, por të ndryshëm në taktikë. Ku qëndron

empatia? Dinë të krijojnë lidhje të fortë me lojtarët, për këtë ata fitojnë besimin. Ndërsa në evolucionin taktik, Inzaghi luan me të njëjtin formacion të përkryer ndër vite, 3-5-2 është një pikë e fortë, jep siguri. Pioli ka ndryshuar më shumë, ai tashmë përdor më shpesh 4-3-3 me ne, por fitoi një titull me 4-2-3-1", ka deklaruar Tare.



Ronaldo: Para gjashtë muajsh më morët për të çmendur

RIYADH, 7 SHTATOR - Cristiano Ronaldo ka folur në lidhje me rivalitetin me Lionel Messin, kurse është rikthyer të flasë edhe për Arabinë Saudite. Ky vend ka shpenzuar miliona pafund, duke tërhequr disa emra të tjerë të mëdhenj në kampionatin vendas, normalisht pasi shkoi Cristiano Ronaldo. "Kampionati saudit është i bukur, por ju gjykoni pa i parë ndeshjet. Është një ligë e mirë dhe e fortë. Po e shihni vetë se çfarë po ndodh me afatet kalimtare dhe afimet", ka thënë Ronaldo. Portugezi i famshëm e ka kujtuar deklaratën e tij të dhënë para disa muajsh, kur kishte thënë se Superliga e Arabisë do të kthehet në pesë kampionatet më të forta në botë. "Unë e dija se do të ndodhte kështu në Arabi. E thashë



gjashtë muaj më parë, por më morën për të çmendur. Por, në fund të fundit, po rezulton se i çmenduri nuk është kaq i çmendur. Dhe po rezulton të jetë normale të luash në Arabinë

Saudite. Për mua ishte një privilegj i madh ta ndryshoja kulturën e një vendi në aspektin futbollistik dhe të shihja një të mëdhenj të shkojnë në Arabinë Saudite", ka thënë sulmuesi i Al-Nassrit.

SHKURT

Medvedevi fitoi derbin rus, sfidon Alcarazin në gjysmëfinale

Janë përcaktuar çiftet gjysmëfinaliste në grand slam të US Open. Në çerekfinale, numri 1 në botë dhe kampioni në fuqi, Carlos Alcaraz, mundi 3-0 (6-3, 6-2, 6-4) gjermanin Alexander Zverev. Ndeshje e mirë e spanjollit, që synon ta mbrojë titullin kampion. Përballë tij do të jetë numri 3 në botë, rusi Daniil Medvedev, që në çerekfinalen tjetër mundi 3-0 (6-4, 6-3, 6-4) patriotin e tij Andrey Rublev. Në çastet vendimtare, përvoja e Medvedevit bëri dallimin në fushë. Te femrat, sfida e dytë gjysmëfinale është ajo në mes të amerikanes Madison Keys (numri 17) dhe bjelloruses Aryna Sabalenka (numri 2). Keys mposhti 2-0 (6-1, 6-4) çeken Marketa Vondrousova, ndërsa bjellorusja mundi 2-0 (6-1, 6-4) kinezin Quai Zheng.

Mourinho: Nëse e them mendimin tim për finalen me Sevillan, më pezullojnë me 10 ndeshje

"Finalja Romë - Sevilla? Nëse them atë që mendoj... do të kem dhjetë ndeshje shkualifikim", kështu tha Jose Mourinho, trajneri i Romës, i cili edhe një herë për mediet italiane e ka komentuar finalen e Ligës së Evropës. Duke kujtuar dy finalet, në Ligën e Konferencës ndaj Feyenoordit, me trofeun që italianët e fituan në "Air Albania" dhe më pas finalen e Ligës së Evropës ndaj Sevillas të cilën Roma e humbi, portugezi theksoi se nuk kishte qarë ndonjëherë në fushë. "Nuk kam qarë kurrë në fushë pas një disfate. Ndonjëherë qaj pas një fitoreje dhe këto të dyja ishin historike për Romën", ka shtuar trajneri për dy finalet evropiane me Romën.

Presidenti i La Ligës: Do të doja që Messi ta mbyllte karrierën te Barcelona

Të gjithë futbolldashësit në botë prisnin rikthimin e Lionel Messit te Barcelona, por shtatë herë fituesi i "Topit të Artë" vendosi të largohej nga futbollit evropian për t'u transferuar te skuadra amerikane e Inter Miamit. Për kalimin e "pleshtit" në MLS, disa fjalë i ka thënë presidenti i kampionatit spanjoll të futbollit, La Liga, Javier Tebas, i cili për mediet u shpreh se dëshironte që Messi të qëndronte dhe përfundonte karrierën e tij në Spanjë. "Messi e përfundoi karrierën jashtë La Ligës sepse Leo dhe Barcelona nuk ranë dakord. Do të doja që ai të qëndronte dhe ta përfundonte karrierën në Spanjë. Do të ishte më mirë për të, për mua dhe për Barcelonën", ka thënë Tebas.

Balotelli: Kam refuzuar oferta shumë më të larta sesa këto të Arabisë Saudite

Mario Balotelli ka zbuluar se në të kaluarën ka refuzuar një ofertë që ka ardhur me një pagë "shumë më të lartë" sesa ato që ofrohen në Arabinë Saudite hëpërhë. Në një intervistë të fundit me "Controcaldio", 33-vjeçari zbuloi se më parë kishte qenë subjekt i ofertave jashtëzakonisht fitimprurëse nga Kina në kulmin e shpenzimeve të Superligës kineze në fund të viteve 2010. "Unë refuzova një ofertë që ishte shumë më e lartë se shifrat që shpërndareshin në Arabinë Saudite. Pëlqeva të luaja futboll dhe të qëndroja në Marsejë", ka thënë ish-sulmuesi i Interit, Manchester Cityt dhe Milanit.

Gundogan: Barcelona një ëndërr, kam ngjashmëri me Xavin

Në një intervistë të gjatë dhënë për "BILD", mesfushori i Barcelonës, Ilkay Gundogan, foli për lamtumirën e tij me Manchester Cityn këtë verë,

pas përfundimit të kontratës së tij me kampionët e Evropës. "City priti një kohë të gjatë para se ta bënte rinovimin. Në fund rezultoi se ishte koha e

përkryer për t'u larguar nga Anglia. Të luaja për Barcelonën, megjithatë, është një ëndërr që kam pasur si fëmijë", ka thënë Gundogan. "Bisedime me

Xavin? Ne folëm disa herë në telefon. Pata një ndjenjë të mirë. Jemi shumë të ngjashëm në personalitet. Kemi disa karakteristika të ngjashme në mënyrën se si

luajmë. Ndoshta kjo është arsyeja pse ai më pëlqen mua. Xavi ishte një lojtar shumë inteligjent. Ai e kupton vlerën e lojës", ka deklaruar Gundogan.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli:	Zyrtar/e i/e lartë për mbështetje të operimit të sistemeve të pagesave
Departamenti:	Sistemi i Pagesave
Divizioni:	Operimit të Sistemeve
I raporton:	Udhëheqësit të Divizionit të Operimit të Sistemeve
Grada:	5

Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësi:

- Kryen detyrat e parapara në kuadër të procedurave ditore të punës me Sistemet e Pagesave dhe Regjistrin e Llogarive Bankare;
- Angazhohet në realizimin e detyrave të parapara për mbështetje të përdoruesve të sistemeve;
- Bashkëpunon dhe koordinon me Departamentin e Teknologjisë Informativë/BQK, në raste të ngritjes së problemeve të natyrës teknike/operacionale apo sistematike dhe zhvillimeve të reja;
- Bashkëpunon me kompanitë kontraktuese, në funksion të mirëmbajtjes së sistemeve, ngritjes (zhvillimeve shtesë) së funksioneve shtesë dhe testeve të sistemeve ekzistuese;
- Ofron trajnime për pjesëmarrësit e rinjë dhe ndihmon në përgatitjen teknike për këta pjesëmarrës;
- Angazhohet në realizimin e detyrave për punë operuese në SPN për rastet e jashtëzakonshme dhe ofron zgjidhje teknike;
- Angazhohet në përgatitjen e dokumenteve (rregullore, manuale të përdorimit, udhëzime teknike, procedura, etj) për sistemet e DSP-së;
- Angazhohet në përgatitjen e raporteve, procedurave dhe standardeve të ndërlidhura me menaxhimin e rrezikut operacional;
- Duhet të jetë njoftuar me të gjitha funksionet e sistemeve të DSP-së, dhe angazhohet në realizimin e të gjitha detyrave dhe punëve që kërkojnë lidhur me funksionimin e rregullt të tyre;
- Komunikon dhe koordinon aktivitetet me departamentet dhe divizionet tjera të BQK-së lidhur me kërkesat dhe nevojat që rrjedhin për mbarëvajtjen e operacioneve me sistemet e DSP-së;
- Komunikon dhe ofron konsultat sipas nevojës për pjesëmarrësit e sistemit të pagesave, si dhe për palët e treta;
- Monitoron dhe ofron zgjidhje për funksionet teknik që lidhen me sistemet e DSP-së.
- Angazhohet në përcjelljen e zhvillimeve të reja në fushën e shërbimeve të pagesave në BE e më gjerë, me standardet e mesazheve financiare, si dhe në analizimin dhe propozimin për avancimin e funksioneve të sistemeve të pagesave;
- Angazhohet në monitorimin e veglave të ndryshme teknike të ndërlidhura me sistemet e DSP, si dhe përgatitjen e skriptave për filtrim të raporteve të njehershme nga baza e të dhënave;
- Sipas nevojë kryen punë të tjera të lidhura me sistemet që operohen në kuadër të DSP-së të deleguara nga mbikëqyrësi apo hierarkia më lartë apo me obligimet që rrjedhin në kuadër të përgjegjësi të DSP dhe BQK-së.

Njohuritë e kërkuara:

- Njohuri të avancuara mbi sistemet e pagesave dhe të mesazheve financiare;
- Njohuri të avancuara në mirëmbajtjen e aplikacioneve kompjuterike të pagesave;
- Njohuri mbi menaxhimin e rreziqeve operacionale;
- Shkathtësi në nxjerrjen e të dhënave statistikore nga sistemet, sipas nevojave dhe natyrës së punës;
- Njohuri të mirë të menaxhimit të drejtave të shfrytëzuesve në aplikacionet bankare; dhe
- Njohuri në mbrojtjen e aplikacioneve kompjuterike nga sulmet dhe dëmtimet e mundshme kibernetike.

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Diplomë universitare në fushën e IT-së, inxhinierisë, ekonomisë (në drejtimet menaxhment dhe informatikë apo banka dhe financa);
- Përvojë prej së paku tre (3) viteve me aplikacione-sisteme kompjuterike të ndërlidhura me sistemet e pagesave ndër-bankare;
- Përparësi kanë kandidatët me përvojë dhe njohuri në administrimin dhe mbështetjen teknike të sistemeve të pagesave ndër-bankare si dhe mesazhet financiare të përdorura në këto sisteme;
- Njohuri të avancuara të gjuhës angleze.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TRUSTI) ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar përvojën e punës;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **22 shtator 2023**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.**
- Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e shpalljes do të kontaktohen.**



OBJAVLJIVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Naslov:	Viši službenik za podršku funkcionisanja platnih sistema
Odeljenje:	Platni sistem
Odsek:	Funkcionisanje sistema
Izveštava:	Rukovodiocu Odseka za funkcionisanje sistema
Stepen:	5

Opis dužnosti i odgovornosti:

- Obavlja poslove predviđene u okviru dnevnih procedura rada sa platnim sistemima i registrom bankovnih računa;
- Angažuje se na realizaciji zadataka predviđenih za podršku korisnicima sistema;
- Sarađuje i koordinira sa Odeljenjem za informacione tehnologije/CBK, u slučajevima pojavljivanja tehničkih/operativnih ili sistemskih problema i novih dešavanja;
- Sarađuje sa ugovornim kompanijama, u funkciji održavanja sistema, razvoja (dodatnog razvoja) dodatnih funkcija i testiranja postojećih sistema;
- Pružava obuku za nove učesnike i pomaže u tehničkoj pripremi ovih učesnika;
